



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.Shk II.nr.1438/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami në çështjen përmbarimore të kreditorit Raiffeisen Bank Kosovo (RBKO), me seli në Prishtinë, rr. “Robert Doll” nr.99, kundër debitorit 1.D.P.T. “Ariani” përfaqësues B.S.B., Kaçanik, me numër të biznesit 80269129, 2. B.S. me numër personal ... (Garantues personal), Biçec, Kaçanik, 3. I.S. me numër personal ... (Bashkë-Kredimarrësi), Biçec, Kaçanik, 4. B.S. me numër personal ... (Garantues), Biçec, Kaçanik, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorëve të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2019/22 të datës 31.08.2023, me datë **01.03.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorëve 1.D.P.T. “Ariani” 2. B.S., 3. I.S. dhe 4 .B.S. ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2019/22 të datës 31.08.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin KPPP.nr.2019/22 të datës 31.08.2023, ne dispozitiv të aktvendimit ka refuzuar si te pabazuar prapësimin e debitorëve 1.D.P.T. “Ariani” 2. B.S., 3. I.S. dhe 4. B.S. ushtruar kundër Urdhrit për lejimin e përmbarimit numër P.nr.71/22 të datës 11.03.2022, i lejuar nga Përmbaruesit Privat Ilir Mulhaxha.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor kanë ushtruar ankesë debitorët nëpërmjet përfaqësuesit të tyre të autorizuar, (*me pretendime sikur në ankesë*) duke kërkuar nga gjykata e shkallës së dytë të anuloj vendimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2019/22 të datës 31.08.2023 dhe të bie vendim që edhe njëherë të shqyrtohet lënda në gjykatë. Mbi arsyet e lartcekura ka kërkuar nga gjykata të vendos si në propozimin e lartpërmendur.

Kreditori ka ushtruar përgjigje ne ankesë nëpërmejt së cilës ka theksuar se dokumentet të cilat i ka bashkngjitur kreditori paraqesin titull ekzekutiv në kuptim të nenit 27 par.1 të LPP-së, që në rastin konkret kemi të bëjmë me peng dhe sipas ligjit në fuqi dokumenti i tillë e përmbush kushtin e titullit ekzekutiv pasi që krijimi i pengut është regjistruar në regjistrin e pengut andaj kërkuar nga gjykata që ankesën e debitorëve ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

- Ankesa e debitorëve është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Raiffeisen Bank Kosovë (RBKO), me seli në Prishtinë, ka lëshuar Urdhrin përbarimor P.nr.71/22 të datës 11.03.2022, me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë mbi bazën e dokumentit Marrëveshje mbi Kredinë nr.200715051, në shumën prej 25,000.00 €, të datës 11.09.2018, shtojcën nr.2 të Marrëveshjes mbi kredinë nr.200715051, Marrëveshjes mbi kredinë nr.200720696 për shumën 10,000.00 € dhe Marrëveshjen për lëshimin e Shfrytëzimit e Visa Biznes Kredit Kartelës të datës 21.12.2018 në vlerë prej 3000.00 €, është lejuar përbarimi ashtu që detyrohen debitorët të paguajnë borxhin prej 19,5621 € për Marrëveshjen mbi Kredinë nr.200715051. Debitori D.P:T Ariani me përfaqësues B.S. edhe borxhin prej 9,625.39 € për Marrëveshjen mbi Kredinë nr.200720696, si dhe borxhin prej 2,547.29€ për Marrëveshjen mbi Lëshimin dhe shfrytëzimin e Visa Biznis Kredi Kartelës, borxhi në shumën e përgjithshme prej 31,735.29 € si dhe kamata e rregullt dhe kamatvonesa që do të arrij deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore të gjithë këtë në afat prej 7 ditësh, me bllokim të gjitha llogarive nëpër të gjitha bankat komerciale në emër të të gjithë debitorëve, sekuestrohet kolaterali i cili përbëhet nga a) Frigorifera nitune për pije, friza për ngrirje, laptop në lokaë, raftat e mallit, pajisje dhe mjete shtëpiake në lokal, mall artikuj ushqimorë dhe jo-ushqimorë (detergjente, ëmbëlsira, pije të ndryshme, kozmetikë, ngjyra, miell); (pronë e D.P.T Ariani); b) veturë 4 dyer, me numër të shasisë ..., me targa ...; Veturë karavan 5 dyer, me numër të shasisë ..., me targa ...; (pronë e B.S.), si në listat e pengut dhe i njëjti i dorëzohet kreditorit për ta shitur që të realizoj kërkesën e vet ndaj debitorit.

Përbaruesi Privat Ilir Mulhaxha me seli në Prishtinë duke vepruar sipas propozimit për përbarim të kreditorit me urdhrin përbarimor P.nr.71/22 të datës 11.03.2022, e ka lejuar përbarimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim duke theksuar se kreditori ka prezantuar tek Përbaruesi Privat dokumentacionin e rrejshëm dhe të pavërtetë pasi që nuk e kanë obligimin e cekur ndaj Bankës Raiffeisen. Tutje theksojnë se ju njoftojmë se ndaj veprimit të prezantimit të rrejshëm dhe të pavërtetë të dëshmime të lartcekura, duke dëmtuar imazhin e kompanisë me veprime të pavërteta do të paraqesim kallëzim penal ndaj Bankës Raiffeisen dhe përfaqësuesve të saj.

Kreditori, në përgjigjen në prapësim ka kundërshtuar pretendimet e debitorëve si plotësisht të pabaza pasi që debitorët nuk kanë paraqitur prova që e mbështesin prapësimin, andaj i propozoi

Gjykatës që ta refuzoj propësimin dhe të vërtetoj urdhrin për lejimin e përmbarrimit dhe të vazhdohet procedura e përmbarrimit.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, pas vlerësimit të propësimin, përgjigjes në propësim dhe shkresave në lëndë, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.2019/22 të datës 31.08.2023, me të cilin ka refuzuar si të pabazuar propësimin e debitorëve 1.D.P.T. “Ariani” 2. B.S., 3. I.S. dhe 4. B.S. ushtruar kundër Urdhrit për lejimin e përmbarrimit numër P.nr.71/22 të datës 11.03.2022, i lejuar nga Përmbarruesit Privat Ilir Mulhaxha.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka vlerësuar se dokumentet përmbarruese përbëjnë bazë juridike për caktimin e përmbarrimit, ngase i kanë plotësuar kushtet ligjore nga neni 27 i LPP-së, për të qenë të përmbarrueshme dhe njëkohësisht të përshtatshëm për përmbarrim.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka marr aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj vendimin e gjykatës, lidhur me këtë çështje e pranon edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë faktin se baza juridike për caktimin e përmbarrimit, kushtet ligjore që duhet të plotësohen për të caktuar përmbarrimin sipas dokumentit të përmbarrimit, parashihen sipas dispozitës së nenit 22 par.1 nën par 1.7 i Ligjit për Procedurën Përmbarrimore, Ligjit për Procedurën Përmbarrimore, nr.05/L-118 të, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore ku në mesin e dokumenteve përmbarrimore në bazë të cilave organi përmbarrues mund të caktoj përmbarrimin është edhe kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut.

Dhoma e Shkalles se Dytë, vlerëson se nuk qëndron pretendimi ankimor i debitorit se aktvendimi i atakuar është marrë me konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se dokumenti në bazë të cilit është lejuar urdhri përmbarrimor nuk paraqet dokument përmbarrimor, për faktin se në rastin konkret përmbarruesi privat e ka lejuar përmbarrimin duke u bazuar Marrëveshje mbi Kredinë nr.200715051, në shumën prej 25,000.00 €, të datës 11.09.2018, shtojcën nr.1 të Marrëveshjes mbi kredinë nr.200715051 (Marrëveshja mbi Pengun), Marrëveshjes mbi kredinë nr.200720696 për shumën 10,000.00 € dhe Marrëveshjen për lëshimin e Shfrytëzimin e Visa Biznes Kredit Kartelës të datës 21.12.2018 në vlerë prej 3000.00 dhe te njëjtat paraqesin

dokumente përmbarese në kuptim të dispozitës së nenit 22 par.1 nën par 1.7 i Ligjit për Procedurën Përmbarese, me të cilën parashihet se “1. *Dokumente përmbarese janë 1.7. kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit*” ndërsa me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarese me nenin 5 përcaktohet si në vijim” 2. *Neni 22 i ligjit bazik, paragrafi 1., pas nën-paragrafit 1.7., shtohet nën-paragrafi ri 1.7a. me tekstin si në vijim. 1.7a. kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut.*

Andaj, Marrëveshja për Pengun është regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pengut në Ministrinë e Trgtisë dhe Industrisë dhe si e tillë paraqet titull përmbarese në pajtim me dispozitat e lartcekura.

Gjykata e shkallës së dytë ka analizuar edhe pretendimet tjera të debitorit por të njëjta mbesin vetëm në natyrën deklarative dhe të pambështetura në prova konkrete siç parasheh dispozita 69 par.4 të LPP dhe si të tilla nuk janë relevante për vendosje ndryshe prandaj kanë rezultuar si të pathemelta të cilat gjykata ankimore vendosi të refuzojë ndërsa aktvendimin e atakuar vendosi ta vërtetojë.

Përndryshe, në procedurën përmbarese bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarese i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarese që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbaresin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMA E SHKALLËS SE DYTË
K.DH.SH.II nr.1438/23. me datë 01.03.2024

Gjyqtari,
Faton Bajrami